



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/70
Datë: 21.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.08-P-042 të datës 21 mars 2022, jep mendim lidhur me Nismën legislative për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L- 115, me Ligjin Nr.04/L- 168 dhe Ligjin Nr.05/L-116.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk vlerëson Nismën legislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L- 115, me Ligjin Nr.04/L- 168 dhe Ligjin Nr.05/L-116, si të nevojshme.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës është afër qytetarëve, për të ndihmuar përmes rishpërndarjes, rritjes së punësimit, rritjes së mbështetjes në skemat sociale, fëmijëve, grave dhe të rinjve, si dhe fermerëve e ndërmarrësisë së vogël e të mesme. Tërheqja nga Trusti nuk ndihmon kategoritë në nevojë, pasi vetë përqindja e fondit pensional të tyre është e ulët. Me kursimin e pleqërisë nuk duhet abuzuar dhe veprimin e atillë, duhet konsideruar si të mangët.
4. Nisur nga kjo që u tha më lart, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk përkrah iniciativën e deputetëve nënshkrues të nismës legislative, të përshkruar si në pikën 2. të këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/70

Datë: 21.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.08-P-044 të datës 21 mars 2022, jep mendim lidhur me Nismën legjislative për Projektligjin për Rregullimin e Çmimit të Produkteve Medicinale.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës ka në agjendë legjislative Projektligjin për Rregullimin e Çmimit të Produkteve Medicinale, rrjedhimisht, nuk konsideron të nevojshme iniciativën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë aspekt.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/70
Datë: 21.04.2022

Në mbështetje të nenit 17, 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Drejtësisë për nënshkrimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministres së Drejtësisë për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/70
Datë: 21.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 11. të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 06/143 i datës 28 prill 2017, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 16/48 të datës 7 dhjetor 2020 dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 02/54 të datës 12 janar 2022.
2. Pika 2. e Vendimit të cekur më lartë riformulohet si në vijim:
Mandati i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës është 8 (tetë) vjeçar.
3. Obligohet Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të gjitha institucionet e tjera që janë të përfshira sipas legjislacionit, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/70

Datë: 21.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. Nën-pika 2.62 e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/50 të datës 23 dhjetor 2021, si në vijim:
 - 1.1. Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr.09/2015 për Lejen për Vendosjen në Treg, Regjistrim dhe Leje Importi të Produkteve Biocide, mbetet në fuqi deri në krijimin e bazës së re ligjore.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të Qeverisë Nr. 02/50 i datës 23 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 05/56 të datës 26 janar 2022, bëhet me qëllim të mos krijimit të vakumit juridik.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë